

HALIM PURELLKU**SHTRIRJA E KRYENGRITJES SHQIPTARE KUNDËROSMANE
E VITIT 1912 NË VILAJETIN
E MANASTIRIT**

Përgatitjet për fillimin e kryengritjes shqiptare kundërosmane, kishin filluar që në dimrin e vitit 1911-1912. Shqiptarët në Kosovë asokohe kishin filluar të punonin, veç tjerash, edhe për formimin e një Komiteti të kryengritjes, i cili do të drejtonte organizimin dhe zhvillimin e saj.¹ Ideja për një kryengritje kombëtare kundërosmane gjeti mbështetje edhe ndër shqiptarët e vilajetit të Manastirit. Më 20 janar të vitit 1912, qe organizuar një miting në Dibër, në të cilin u shtrua kërkesa që po ato të drejta që u njiheshin malësorëve, me marrëveshjen e Podgoricës (2 gusht 1911), të u njiheshin edhe popullatës së krahinës së Dibrës. Vendimet e këtij kuvendi u dërguan edhe deputetëve shqiptarë, në Stamboll, për informim.²

Kryengritja shqiptare kundërosmane e cila filloi nga mesi i muajit prill të vitit 1912 në krahinat e Dukagjinit, Plavës e Dibrës, do t'i tejkalojë suazat lokale-krahinore dhe u ngrit në shkallë të kryengritje së përgjithshme shqiptare.³ Ndonëse formalisht kërkesat e kryengritësve shqiptarë, marrë në tërësi, qëndronin në suaza të privilegjeve që pushteti osman paraprakisht ua kishte njohur malësorëve (1911),⁴ shqiptarët e

¹ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.PA.A.*) në *Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë* (më tej: *AIH*), (Dokumente të përkthyer në gjuhën shqipe), Vj-22-2-288, Telegram i Kral - Berchtold-it, Selanik, më 25.06.1912.

² *Po aty*, Vj-22-11-1102, Telegram i Halla - baronit Erental, Manastir, më 5 shkurt 1912; Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare shqiptare (1911-1912)*, Libri 2, Prishtinë: 2004, f. 160.

³ Shih gjerësisht: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 461-500; R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare ...*; Б. Храбак, “Арбанашки устанци 1912 године”, në *Врањски гласник*, књ. XI, Врање, 1975, etj.

⁴ Врење Арнаута, “Заплет у Албанији”, *Борба*, Бр. 21, Београд, 28.04/11.05.1912 (Administrata serbe dhe shtypi serb i kohës bënte njësimin e kohës sipas kalendarit të

dinin se ç'duan dhe me vendosmëri shkonin drejt qëllimit të vet: "Autonomia e Shqipërisë ... është ai qëllimi më i lartë dhe forcë e përhershme promotor, që i bënë të vendosur shqiptarët për trazira dhe kryengritje kaq të shpeshta", vlerësonte një autor serb me pseudonimin "Orlowsky", në një shkrim të tij analitik në gazetën "Borba", të Beogradit.⁵ Ndërkaq, Hasan Ballanca, nga Dibra, një veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare, vlerësonte në deklaratën e tij për gazetën bullgare "Reç", se lëvizja aktuale revolucionare kryengritëse në Shqipëri, nuk ishte si ato të mëparshmet në kuptimin e shkallës së organizimit dhe të karakterit të saj.⁶ Kjo kryengritje dallonte nga ato të mëparshmet, sepse motivet për shpërthimin e saj ishin komplekse, ato ishin të karakterit: social, kulturor, politik dhe kombëtar. Ajo çka e dallonte më së shumti këtë kryengritje ishte, veç tjerash, edhe përfshirja në kryengritje jo vetëm e masave, por dhe e një pjesë të elitave të shoqërisë shqiptare të kohës intelektuale, politike, ekonomike etj., duke i dhënë kështu kryengritjes dimensione të seriozitetit të plotë në planin ideor dhe në atë organizativ. Prandaj dhe kjo kryengritje ia doli që të marrë përmasa të kryengritjes së përgjithshme kombëtare, me objektiv sublim njohjen e autonomisë së Shqipërisë në kufijtë e saj etnik e gjeografik, si fazë kalimtare drejt pavarësisë.⁷

Që me shpërthimin e kryengritjes në Shqipërinë e Veriut, nga mesi i muajit prill të vitit 1912, drejtues dhe qarqe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare po punonin për shtrirjen e saj në gjithë Shqipërinë, dhe në dekadën e dytë të muajit maj të vitit 1912 Kryengritja qe shtrirë, apo së paku ndjehej, në të gjithë Shqipërinë (Arnautllëkun),⁸ përkatësisht, siç pohonte shtypi i kohës në Beograd, kryengritja shtrihej nga kufiri shtetëror me Serbinë, në veri, e "deri në kufijtë më të skajshëm jugor" të

vjetër, i cili dallonte nga ky i sotmi për 13 ditë, ndaj dhe në fusnota janë shënuar njëherit që të dyja datat).

⁵ "Најнови Арнаутски покрет", *Борба*, Бр. 28, Београд, 5/18.05.1912.

⁶ "Арнаути у Софији", *Политика*, бр. 2985, Београд, 10/23.05.1912; "Арнаутска револуција", *Политика*, бр. 2986, Београд, 11/24.05.1912.

⁷ Shih gjerësisht: *Historia e Popullit Shqiptar ...*, II, f. 461-500; R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare ...*; Б. Храбак, "Арбанашки устанци 1912 године", në *Врањски гласник*, књ. XI, Врање, 1975.

⁸ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj-22-2-288, Telegram i Kral - Berchtold-it, Selanik, më 25.06.1912.

Shqipërisë, në jug, dhe nga brigjet e liqenit të Shkodrës, në perëndim, e deri në Vardar, në lindje.⁹

Ndërkaq, qeveria osmane, ishte në dijeni për idenë e një kryengritjeje të armatosur shqiptare edhe në vilajetin e Manastirit. Ajo, në fillim të marsit 1912, mori masa për parandalimin e saj. Për këtë qëllim, qeveria ngarkoi Feti Pashën, komandant i Korpusit VI dhe valiun e Manastirit, të bisedonin me disa figura të jetës publike e politike shqiptare, si: Dervish Hima, Fehim Bej Zavalani, Abdyl Bej Ypin, baba Hysenin e Melçanit, për t'iu kërkuar atyre që shqiptarët të qëndrojnë asnjans (neutral) në luftën politike midis pozitës dhe opozitës osmane, si dhe të heqin dorë nga ideja e kryengritjes.¹⁰

Megjithatë, kryengritja u shtri edhe në vilajetin e Manastirit. Në përmasa më të mëdha dhe me një intensitet më të lartë, ajo u ndiye në sanxhakun e Dibrës, në kazanë e Kërçovës dhe në sanxhakun e Korçës. Një rol të rëndësishëm në organizimin dhe zhvillimin e kryengritjes kundërosmane, edhe në vilajetin e Manastirit, luajtën paria opozitare shqiptare nga qytetet,¹¹ si dhe kandidatët opozitarë për deputet, të cilët, me praninë e tyre në radhët e kryengritësve, të gjithë kryengritjes i jepnin në përgjithësi karakter më serioz e parimor kombëtar.¹²

Organizimi i çetave kryengritëse dhe rebelimi i tyre në krahinën e Dibrës u duk nga fundi i prillit 1912, kur dhe Basri beu u arratis në mal dhe grumbulloi disa qindra kryengritës shqiptarë.¹³ Krahas, Basri Beut, u rebeluan edhe disa krerë me ndikim ndër malësorët, si Mersim Dema, Elez Isufi, Sejfedin Pustina, Shaqir Beu e Salih Bej Lacko. Takimet dhe konsultimet midis tyre i mbanin në Shupenzë (Dibër).¹⁴ Nga prijësit më të shquar të kryengritjes në krahinën e Dibrës ishte Mersim Dema, i cili

⁹ “Побуна Арнаута (Данашњи хаос у Турској)”, *Борба*, Бр. 26, Београд, 3/18.05.1912; “Ширење Арбанског покрета”, *Борба*, Бр. 36, Београд, 15/28.05.1912; “Арнаути у Софији”, *Политика*, бр. 2985, Београд, 10/23.05.1912; “Арнаутска револуција”, *Политика*, бр. 2986, Београд, 11/24.05.1912; “Вихор у Турској”, *Политика*, бр. 3042, Београд, 8/21.07.1912.

¹⁰ *ННSt.A.P.A.A.* në *АИН*, Vj-22-19-(?), Konsulli Halla - Kontit, Manastir, më 9.03.1912.

¹¹ “Писмо из Призрена (Од нашег редоног дописника - 30.04/13.05.1912)”, *Борба*, Бр. 30, Београд, 7./20.05.1912.

¹² *Документи о спољној политици Краљевине Србије (1903-1914)*, Књг. 5, св. 1, док. нр. 480, f.771.

¹³ “За Басри-бејом”, *Политика*, бр. 2980, Београд, 5/18.05.1912.

¹⁴ *ННSt.A.P.A.A.* në *АИН*, Vj-22-17-1757, Telegram i konsullit Halla, Manastir, më 27.05.1912.

me çetën e tij (50 veta) zhvilloi një veprimtari shumë efikase, në favor të masivizimit të kryengritjes. Ndërkohë, nga fundi i prillit 1912, në Dibërën e Poshtme (Vogël) nga këto krerë qenë organizuar dhe vepronin disa çeta kryengritëse me efektiva nga 40-50 veta secila nga ato.¹⁵ Kryengritësit kishin këshilltarët dhe instruktorët e tyre në qytetin e Dibrës: Sefedin Pustinën, Shukri Beun etj.¹⁶

Gjithashtu, edhe në kazanë e Kërçovës pas përgatitjeve të para për kryengritje u kalua në riorganizimin dhe në krijimin e çetave të reja të armatosura, të cilat në pranverë të vitit 1912 u riaktivizuan, kurse nga fundi i marsit të këtij viti ishin në aktivitet të plotë.¹⁷ Udhëheqës të kryengritjes në kazanë e Kërçovës ishin Ali Jonuzi-Drogomishti, Haki Efendi dhe Nuhi Xhemë Pashaliu (Shutova) etj.¹⁸ Kurse, qendër e veprimtarisë politike e organizative e lëvizjes kryengritëse-revolucionare në këtë kaza ishte fshati Zajaz, ku, si duket, qe ngritur një Komision (Komitet/Shtab) i kryengritjes, sepse këtu njëherazi ishte dhe vendtakimi për konsultime dhe koordinime të çetave shqiptare në aksione.¹⁹ Sipas të dhënave të konsullit serb dhe atij austro-hungarez në Manastir, në pranverë të vitit 1912 në kazanë e Kërçovës vepronin rreth dhjetë (10) çeta kryengritëse shqiptare. Çetat drejtoheshin nga prijësit e tyre, dhe mesatarisht numëronin nga 6 deri në 40 veta. Komandant i përgjithshëm i çetave ishte Nuhi Pashaliu-Shutova, nga fshati Shutovë.²⁰ Por, nga fundi

¹⁵ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 401, f. 664; R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare ...*, f. 209.

¹⁶ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 351, f. 602.

¹⁷ R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare ...*, f. 206.

¹⁸ *Државен архив на Република Македонија* (më tej: ДАРМ), Скопје, Фонд (më tej: ф.), Дипломатски архив-Белград, Микрофилм (më tej: М.) 904, ПП Бр. 466, Битољ, 18/31 маја 1912, L. Mihajloviq, kosull i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd; Kryengritësit e Shqipnis, gazeta *Shkupi*, nr. 32, Shkup, 30 gusht 1912, f. 2.

¹⁹ *Архив на институтот за национална историја*, Скопје (më tej: АИНИ), ФК. П. 3/8, Извештаи на австриските конзули-Македонија 1911-1912, Инвентар бр. 22/67, Shtojcë për raportin ddo., Manastir, 14.06.1912, Nr. 54, Kundërbandat turke në vilajetin e Manastirit - Rajoni i Kërçovës; *Документи о спољној политици...*, Књига V, Свеска 1, 1/14. јануар-14/27. јули 1912, Приредио Михајло Војводић, Београд, 1984, dok. nr. 401, f. 665.

²⁰ ДАРМ, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 466, Битољ, 18/31 маја 1912, L. Mihajloviq, kosull i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd; АИНИ, Скопје, ФК. П. 3/8, Извештаи на австриските конзули-Македонија 1911-1912, Инвентар бр. 22/67, Shtojcë për raportin ddo., Manastir,

i marsit e deri në dekadën e parë të muajit maj 1912, veprimi i këtyre çetave kufizohej në aksione mobilizuese.²¹

Krerët e Dibrës (në numër 39), nga fundi i prillit 1912, me anë të një telegrami protestonin pranë qeverisë osmane, kundër praktikës së shkeljes flagrante të procesit zgjedhor nga ana e pushtetit, në sanxhakun e Dibrës.²² Por, qeveria osmane në vend që të ndalon praktikën e shkeljes flagrante të procesit zgjedhor në sanxhakun e Dibrës, dërgoi një ekspeditë të madhe ndjekje kundër çetës së Basri Beut. Përleshjet midis ushtrisë dhe kryengritësve, në Malësinë e Dibrës, filluan nga fundi i prillit-fillimi i majit 1912. U zhvilluan tri përleshje në fshatrat Reç, Dardhë dhe Çidhën. Gazeta “Politika” e vlerësonte kryengritjen e Dibrës si shumë serioze “më të organizuar se asnjëherë më parë”.²³ Në dhjetëditshin e parë të majit, kryengritja në Dibër të Poshtme po merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha. Thuajse e gjithë Malësia e Dibrës qe ngritur në kryengritje. Kjo rezultoi me luftime të shpeshta, herë pas here të formës frontale, ndërmjet fuqive kryengritëse dhe ushtrisë osmane gjatë muajit maj të vitit 1912, dhe atë ndërmjet fshatrave Dardhë dhe Reç, te fshati Topojan, te fshati Lis, te lumi Lusi etj. Kështu, më 4 maj 1912 forcat ushtarake u përleshën me çetën e Elez Isufit, ku mbetën të vrarë dy shqiptarë dhe 11 ushtarë osmanë të vrarë e të plagosur.²⁴ Ndërkaq, rreth 14 maj, trupat osmane të Batalionit të dytë të Regjimentit të 49 në luftë me kryengritësit shqiptarë pësuan humbje të mëdha në njerëz; rreth 100 ushtarë të vrarë.²⁵ Kurse, rreth datës 17 maj në fshatrat Reç e Dardhë të Malësisë së Dibrës pati një përpjekje tjetër të luftës frontale midis çetave shqiptare dhe trupave osmane. Kryengritësve u erdhën në ndihmë Mersim Dema me 400 luftëtarë dhe fshatarët e fshatrave përreth. Përpara

14.06.1912, Nr. 54, Kundërbandat turke në Vilajetin e Manastirit-Rajoni i Kërçovës; *HHS.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 22-19-1975, Konsulli Karl Halla, gjendja në Kërçovë, Banditizmi, Manastir, më 1 qershor 1912.

²¹ *ДАРМ*, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 905, ПП Бр. 412, Битољ, 2/15.05.1912 г., Konsulli Mihajloviq nga Manastiri, Ministrisë së PJ në Beograd; *po aty*, М. 900, ПП Бр. 469, Битољ, 18/31.05.1912, Konsulli i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd.

²² *HHS.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj-22-17-1754, Shtojcë e raportit nga Manastiri, më 1.05.1912.

²³ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 316, f. 561; “Арнаутска буна”, *Политика*, бр. 2975, Београд, 30 априлла/13.05.1912.

²⁴ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 401, f. 665.

²⁵ “Побуна Арнаута ...”, Бр. 25, Београд, 2/15.05.1912.

mësymjes së fuqive kryengritëse, trupat osmane ishin të detyruara të mbrapsen.²⁶

Shpejt pas këtyre përlëshjeve, nga Manastiri kishte arritur në Dibër Feti Pasha, me një regjiment të këmbësorisë dhe me një bateri kodrinore, për të demonstruar forcën. Feti Pasha deklaroi se gjoja ka ardhur për t'ua komunikuar prijësve të kryengritjes përgjigjen e qeverisë, lidhur me 10 kërkesat me shkrim të Dibrës së Poshtme dhe të Matit, dorëzuar Haxhi Adil Beut. Në këtë kuadër, ai i ftoi kryengritësit të shpërndahen nëpër shtëpitë e tyre dhe urdhëroi ushtrinë të ndërpres ndjekjen e kryengritësve. Pastaj, Feti Pasha, më 23 maj 1912, shkoi në Homesh, qendër e kryengritjes në Malësinë e Dibrës. Aty ai ua përcolli prijësve të kryengritjes vendimin e qeverisë osmane, se shqiptarët e sanxhakut të Dibrës për disa vjet do të liroheshin nga shërbimi ushtarak dhe se do të hiqeshin taksat e reja. Ndërkaq, udhëheqësve të kryengritjes Basri Beut dhe Mersim Demës, nëpërmjet Shaqir Beut, u bëri oferta shumë solide në ofiqe e të holla për të ndërprerë kryengritjen, por prijësit e kryengritjes i refuzuan këto oferta.²⁷ Gjithashtu, nga fundi i majit në Dibër arriti edhe telegrami nga Stambolli, me anë të të cilit konfirmohej se është anuluar për tri vite tatimi për shqiptarët kryengritës, dhe se është anuluar për tri vite edhe shërbimi ushtarak si dhe ishte legalizuar mbajtja e armëve.²⁸ Ndërkohë, më 26 maj 1912, vali i Manastirit deklaroi, se janë shpërndarë kryengritësit përreth Dibrës, kundruall koncesioneve të pushtetit.²⁹

Përpjekjet e qeverisë osmane për shuarjen e kryengritjes në sanxhakun e Dibrës me mjete paqësore, vazhdonin edhe gjatë muajit qershor të vitit 1912. Shpejt pas deklaratës së valiut të Manastirit, të 26 majit 1912, paraprkisht u evakuua ushtria osmane nga Malësia e Dibrës, në javën e parë të qershorit, si duket ky ishte kushti i shqiptarëve për të hyrë në bisedime me pushtetin. Ndërkaq, nga mesi i qershorit, në Dibër arriti një delegacion i përbërë nga Feti Pasha dhe Ejup Sabri Beu, sekretar i Komitetit Qendror xhonturk, për negociata me kryengritësit, ngase “e

²⁶ “Сукоб војске са Арнаутима”, *Борба*, Бр. 28, Београд, 5/18.05.1912.

²⁷ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, док. нр. 401, ф. 663-665; “Побуна Арнаута (Ради преговиора с Арнаутима dhe Побуна се још шири)”, *Борба*, Бр. 37, Београд, 16/29.05.1912; “Борба с Арнаутима...”, бр. 2989, Београд, 16-29.05.1912; R. Abdylî, *Lëvizja Kombëtare ...*, f. 231, 235.

²⁸ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, док. нр. 435, ф. 703.

²⁹ “Борба с Арнаутима ...”, бр. 2988, Београд, 15/28.05.1912.

gjithë Malësia e Dibrës qe arratisur në mal”. Bisedimet midis pushtetit dhe përfaqësuesve shqiptar për një marrëveshje të përkohshme zhvilloheshin në Dibër. Këto negociata rezultuan me pranimin formal të kushteve të delegacionit osman dhe me zotimin e përfaqësuesve shqiptarë se kryengritësit do të shpërndahen nëpër shtëpitë e tyre.³⁰ Për rrjedhojë, nga fundi i qershorit në Dibër nuk kishte përlëshje, por burimet bëjnë të ditur se ende nuk ishte arritur marrëveshje midis kryengritësve dhe pushtetit.³¹

Ndërkaq, gjatë muajit maj të vitit 1912, lëvizja revolucionare shqiptare, nëpërmjet çetave kryengritëse, qe intensifikuar edhe në kazanë e Kërçovës. Sipas konsullit austro-hungarez, Halla, gjatë gjithë muajit maj 1912 gjendja në kazanë e Kërçovës “është shndërruar shumë keq”.³² Nga gjysma e majit edhe në këtë kaza ishin intensifikuar sulmet e çetave kryengritëse, me mbështetje dhe të popullatës, kundër forcave osmane. Prandaj dhe autoritetet osmane të vilajetit, në Manastir, dhe ato vendore në krye me kajmekamin e Kërçovës, ndërmorën masa energjike politike e ushtarake për të shtypur lëvizjen revolucionare në kazanë e Kërçovës. Ishin ndërmarrë disa ekspedita osmane të ndjekjes kundër çetave kryengritëse.³³ Për ballë aksionit energjik të ekspeditave ushtarake osmane, çetat shqiptare të Kërçovës, me siguri edhe për të shmangur reprezaljet osmane mbi popullatën civile, u dislokuan nëpër male.³⁴

Por, meqë nga fundi i majit veprimtaria kryengritëse në Kërçovë po merrte përpjesëtime të reja serioze, kurse ekspeditat osmane të ndjekjes nuk rezultonin të suksesshme, pushteti osman ndërmori masa plotësuese konkrete ushtarake e politike për të shtypur kryengritjen. Në ditët e fundit të majit dërgoi në Kërçovë trupa shtesë redifë (rezervistë) nga Anadoli,³⁵ e që deri nga fundi i qershorit 1912, efektivat ushtarake osmane redifë të

³⁰ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 480, f.771; “Мир у Дебру, Арнаутска револуција”, *Политика*, бр. 3007, Београд, 3/16.06.1912.

³¹ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 513, f. 814.

³² *ННSt.A.P.A.A.* në *АИН*, Vj. 22-19-1975, Konsulli Karl Halla, gjendja në Kërçovë, Banditizmi, Manastir, më 1 qershor 1912.

³³ *ДАРМ*, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 466, Битољ, 18/31 маја 1912, L. Mihajloviq, kosull i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd.

³⁴ *Документи о спољној политици...*, Књига V, Свеска 1, dok. nr. 435, f. 701.

³⁵ *ДАРМ*, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 466, Битољ, 18/31 маја 1912, L. Mihajloviq, kosull i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd.

dislokuara këtu arrinin në disa batalione.³⁶ Po nga fundi i majit 1912, krahas përqendrimit të forcave osmane shtesë, ndërkohë nga Manastiri arriti në Kërçovë edhe një “Komision” osman i përbërë nga kryetari i gjiqit të apelit, shefi i policisë dhe një nëpunës, me detyrë të qetësonin situatën në këtë kaza.³⁷

Por, përkundër asaj që numri i çetave po rritej, dhe se kryengritja ndër shqiptarët, edhe pse në formë jo të përcaktuara mirë, po zgjerohej. Deri në fund të majit kryengritja nuk mori përmasa shumë të mëdha në vilajetin e Manastirit, por dhe përleshjet e armatosura midis shqiptarëve dhe pushteti këtu nuk u ngritën në lëvizje serioze kombëtare. Megjithatë, qeveria osmane vazhdonte me përforcimin e masave, në radhë të parë ushtarake, por dhe të metodave taktike të tjera parciais manipuluese, për të shpartalluar dhe shuar kryengritjen, si p.sh. vazhdonte të përqendronte trupa ushtarake shtesë në Dibër dhe në Kërçovë, në fund të majit 1912.³⁸

Kujtoj se të gjitha këto masa të pushtetit osman, shtuan dhe më shumë mobilizimin ndër prijësit e kryengritjes edhe në vilajetin e Manastirit, në drejtim të bashkimit dhe të vendosjes së një bashkërendimi të lëvizjes kryengritëse në gjithë Shqipërinë, si kusht për të lëvizur drejt kryengritjes së përgjithshme. Për këto motive, prijësit shqiptarë të vilajetit të Manastirit vazhdonin të forconin lidhjet me Shqipërinë e Sipërme,³⁹ si p.sh. Basri Beu, i cili drejtonte lëvizjen në Dibër, kishte lidhje me udhëheqësit e kryengritësve në Kosovë. Në maj të vitit 1912, qenë intensifikuar përpjekjet për bashkërendimin e veprimeve kryengritëse në gjithë Shqipërinë.⁴⁰ Haki Efendiu, në cilësinë e përfaqësuesit të Kërçovës, në maj të vitit 1912, shkon me mission, siç theksohej në dokument “për punë popullore”-kombëtare në “trevat e Sipërme” të Shqipërisë dhe, qëndroi në Gostivar, në Tetovë, në Prizren dhe në Shkup, me qëllim të bashkimit dhe të vendosjes së një bashkërendimi të lëvizjes kryengritëse të kazasë së Kërçovës me atë të

³⁶ *Po aty*, M. 903, ПП N=3665 Београд, 21.06/4.07.1912 год., Telegram i Ballugxhiqit nga Selaniku, Ministrisë së PJ në Beograd; Б. Храбак, “Арбанашки уста ...”, f. 269.

³⁷ ДАРМ, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 466, Битољ, 18/31 маја 1912, Л. Милајловиќ, консули i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd.

³⁸ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, док. нр. 435, f. 701-703.

³⁹ *Po aty*, Књг. 5, св. 1, док. нр. 435, f. 702.

⁴⁰ *ННSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj-22-17-1757, Telegram i konsullit Halla, Manastir, më 27.05.1912.

Trevave të Sipërme të Shqipërisë, në luftën kundërosmane. Nga ky mision, Hakiu qe kthyer në Kërçovë nga fundi i majit të të njëjtit vit.⁴¹ Në këtë kuadër, edhe Halla, konsulli austro-hungarez në Manastir, njoftonte se “një grup shqiptarësh të kazasë së Kërçovës” kishte qëndruar në Kosovë, në maj të vitit 1912, me qëllim që edhe treva e Kërçovës të bashkohet “me kryengritësit e Shqipërisë së Veriut”.⁴² Ndërkaq, lidhur me bashkimin e forcave shqiptare në luftën kundërosmane, Kral, konsulli austro-hungarez në Selanik, njofton eprorët e tij se me përpjekjen e disa personaliteteve-figurave shqiptare në qershor të vitit 1912, ishte bërë përparim në arritjen e marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet krahinave të Shqipërisë për kryengritje të përbashkët kundërosmane, por ende janë larg nga një marrëveshje “më e sigurt dhe më aktive” siç do të duhej të ishte.⁴³

Përkundër qetësimit të Dibrës gjatë muajit qershor, si rrjedhojë e bisedimeve ndërmjet autoriteteve të pushtetit dhe të drejtuesve të kryengritjes, në vise të tjera të vilajetit të Manastirit vazhdonin përpjekjet midis fuqive kryengritëse dhe forcave osmane edhe gjatë muajve qershor e korrik. Ekspeditat osmane të ndjekjes ndaj çetave kryengritëse shqiptare, do të vazhdojnë edhe në gjysmën e parë të muajit qershor. Suksesi kryesor i kësaj vale të ekspeditave osmane ishte vrasja e Nuhi Xhemë Shutovës, udhëheqës i çetave në Kërçovë, dhe të Jonuzit nga Ostreci.⁴⁴ Trazirat shqiptare në vilajetin e Manastirit, vazhdonin edhe gjatë qershorit të vitit 1912.⁴⁵ Nga mesi i qershorit, kryengritja ishte evidente në hapësirën midis Ohrit e Dibrës.⁴⁶ Ndërkaq, në gjysmën e dytë të qershorit 1912, njoftohej për përpjekje të fuqive osmane me çetat në

⁴¹ ДАРМ, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 466, Битољ, 18/31 маја 1912, L. Mihajloviq, kosull i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd; Masar Rizvanolli, *Zgjedhjet parlamentare në Dibër më 1912 dhe fillimi i qëndresës së armatosur antiosmane*, Universiteti i Prishtinës, Buletin i Fakultetit Filozofik, XXI/1991, Prishtinë: 1993, fq. 137.

⁴² ННSt.A.РА.А. në АИИ, Vj. 22-19-1975, Konsulli Karl Halla, Gjendja në Kërçovë, Banditizmi, Manastir, më 1 qershor 1912.

⁴³ *Po aty*, Vj. 22.2.288, Raport i konsullit austro-hungarez Kral, kontit Berchtold, 25 qershor 1912, nga Selaniku.

⁴⁴ ДАРМ, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 498, Битољ, 27.05/9.06. 1912, L. Mihajloviq, konsulli i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd; *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 480, f.771; Б. Храбак, “Арбанашки устанци 1912 године...”, f. 256 dhe 266; Смрт Глигоровог убице, gazeta „Политика“, Број 3000, Београд, 27.05/9.06.1912.

⁴⁵ “Арнаутска буна ...”, *Политика*, бр. 3009, Београд, 5/18.06..1912.

⁴⁶ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 512, f. 814.

trevën e Kërçovës,⁴⁷ kurse, nga fundi i qershorit, Çermenika deklaroi bashkimin me kryengritjen, falë agjitacionit të Basri Beut.⁴⁸ Gjithashtu, nga fundi i qershorit të vitit 1912, kryengritja po merrte përpjesëtime masive edhe në sanxhakun e Korçës. Asokohe, numri i përgjithshëm i kryengritësve në këtë sanxhak arrinte rreth 450-500 veta. Këto fuqi kryengritëse kryesisht ishin përqendruar në kazanë e Kolonjës dhe në afërsi të Korçës.⁴⁹

Me qëllim të furnizimit me armatime të cilat aq shumë iu mungonin, brenda një muaji, qershor-fillimi i korrikut 1912, fuqitë kryengritëse sulmuan 15 konvoje/transporte ushtarake në vise të ndryshme të Shqipërisë dhe rrëmbyen shumë materiale lufte.⁵⁰ Kështu, asokohe fuqitë kryengritëse shqiptare në të katër anët e vendit, i rrëmbyen ushtrisë osmane gjatë këtyre sulmeve rreth 5000 pushkë të llojeve të ndryshme,⁵¹ dhe vranë shumë ushtarë dhe oficerë osmanë. Duhet theksuar, sulmi i fuqive kryengritëse mbi konvojën/transportin ushtarak osman në Mat, rreth 23/24 qershor 1912, me ç'rast ata rrëmbyen rreth 1000 pushkë e municionin e nevojshëm dhe vranë komandantin e batalionit, tre officerë dhe 30 ushtarë,⁵² sulmi mbi një transport ushtarak në afërsi të Kërçovës, më 30 qershor, dhe rrëmbimin e dhjetë barrë pushkë e municione.⁵³

Por, element i rëndësishëm në zhvillimet politike në vilajetin e Manastirit gjatë qershorit të vitit 1912, ishte revolta antiqeveritare në

⁴⁷ R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare ...*, f. 263.

⁴⁸ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj-22-17-1763, Konsulli Halla - Markgrafit, Manastir, më 25.06.1912.

⁴⁹ Po aty, Vj-22-17-1763, Konsulli Halla - Markgrafit, Manastir, më 25.06.1912; *po aty*, Konsulli Halla - Markgraf, Manastir, më 4.07.1912; *po aty*, Shtojcë e informacionit nga Manastiri, 4.07.1912, Lista e kërësve shqiptarë....

⁵⁰ *ДАРМ*, Скопје, Фонд бр. 18, Краљевско српско посланство-Лондон (1879-1914), Кут. 4, архив. Единица 181, стр. 395 (në vazhdim sipas këtij shembulli: *ДАРМ*, Скопје, 18/4.181/395), ППБр. 357, у Солуну, 23.06./6.0.7.1912, Београду, Konsullati i përgjithshëm i Mbretërisë së Serbisë, në Selanik, ministrit të Punëve të Jashtme; *Документи о спољној политици...*, Књига V, Свеска 1, dok. nr. 578, f. 898-899; Б Б. Храбак, “Арбанашки уста ...”, f. 269.

⁵¹ *ДАРМ*, Скопје, 18.4.181/395, ППБр. 357, у Солуну, 23.06./6.07.1912, Београду, Konsullati i përgjithshëm i Mbretërisë së Serbisë, në Selanik, ministrit të Punëve të Jashtme.

⁵² *Po aty*, 18.4.166/364, ППБр. 3512, 20/06.1912 год., у Београду, Ministra e Punëve të Jashtme e Serbisë, Legatës mbretërore në Londër

⁵³ *Po aty*, 18.4.181/395, ППБр. 357, у Солуну, 23.06./6.07.1912 Београду, Konsullati i përgjithshëm i Mbretërisë së Serbisë, në Selanik, ministrit të Punëve të Jashtme.

ushtri. Në natën e 21-22 qershorit 1912, nga shumë garnizone ushtarake në vilajetin e Manastirit u rebeluan dhe u arratisën një numër i madh ushtarakësh: oficerë, nënoficerë e ushtarë. Oficerët ishin në lidhje me prijësit e kryengritjes në Shqipërinë e Veriut. Numri i oficerëve dhe ushtarëve të arratisur ndër male gjatë kësaj nate, nga garnizonet e Korpusit VI, ishte: në Manastir- 5 oficer (3 shqiptarë) dhe 80 ushtarë, me të cilët ikën (u arratisën) edhe 15-20 shqiptarë të shquar; në Përlepe-5 oficerë dhe 16 ushtarë; në Korçë-25 ushtarë; në Dibrër-5 oficerë, 120 ushtarë dhe 6 krerë-pari; në Ohër-3 oficerë e 23 ushtarë; në Resnjë-1 oficer e 7 ushtarë; në Kërçovë-10 ushtarë.⁵⁴ Ndërkaq, sipas burimeve diplomatike serbe, numri i saktë i ushtarëve të arratisur nga llogori i Bistricës, pranë Manastirit, natën e 21-22 qershorit, ishte 180 ushtarë dhe 4 oficerë. Atyre iu bashkuan edhe 34 shqiptarë nga fshatrat përreth, që nën komandën e kapitenit Tajar ishin gjithsej 214 veta. Sipas këtyre burimeve, numri i ushtarëve të arratisur nga garnizonet e tjera, i Përlepes, i Ohrit, i Resnjës, ishte mbi 66 oficerë e ushtarë. Shumë ushtarë, numri i të cilëve nuk jepej, dezertuan edhe nga garnizonet e Dibrës,⁵⁵ të Kërçovës dhe Elbasanit, dhe iu bashkuan kryengritësve shqiptarë.⁵⁶

E rëndësishme është se revolta antiqeveritare në ushtri, i dha një impuls të ri kryengritjes shqiptare në vilajetin e Manastirit. Një pjesë e ushtarakëve u bashkuan me kryengritësit, dhe së bashku me trupat e dezertuara u arratisën edhe shumë krerë të zonave përkatëse në këtë vilajet. Kështu, me trupat e dezertuara nga garnizoni i Dibrës, më 22 qershor 1912, u arratisën edhe 12 krerë nga sanxhaku i Dibrës, të cilët qëndronin në Malësinë e Dibrës, me 80-100 burra.⁵⁷ Gjithashtu, edhe nga sanxhaku i Korçës ishin arratisur një numër i parisë të shoqëruar nga më

⁵⁴ *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj-22-2-286, Telegram nga Markgraf Pallaviçini, Jenikoj, më 25.06.1912; *po aty*, Vj-22-18-1808, Konsulli Halla - Markgraf, Manastir, më 27.06.1912, Shtojcë, e raportit nr. 63, nga Manastiri, 27.06.1912.

⁵⁵ *ДАРМ*, Скопје, 18.4.161/355, ППБр. 3508, 14/27.06.1912 год., у Београду, Министра е Punëve të Jashtme të Serbisë, Legatës mbretërore në Londër; *po aty*, 18.4.162/356, ППБр. 3509, 14/27.06.1912 год., у Београду, Министра е Punëve të Jashtme të Serbisë, Legatës mbretërore në Londër.

⁵⁶ “Буна у турској војсци ...”, *Политика*, бр. 3018, Београд, 14/27.06.1912.

⁵⁷ *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj-22-17-1763, Halla - Markgrafit, Manastir, më 25.06.1912; *po aty*, Halla - Markgrafit, Manastir, më 4.07.1912; *po aty*, Shtojcë e informacionit nga Manastiri, 4.07.1912, Lista e krerëve shqiptarë...; *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, dok. nr. 571, f. 892; “Бегство из Дебра”, *Политика*, бр. 3022, Београд, 18.06./1.07.1912.

shumë persona të tjerë. Në këtë sanxhak, numrin më të madh të kryengritësve e përbënin 14 krerë të Korçës, të cilët qenë arratisur me 150 veta të tjerë, pastaj ushtarët e dezertuar të Tajar Beut, si dhe çetat e Sali Butkës, të Ali Farmakit e të Dilaver Lubonjës.⁵⁸ Ndërkaq, pjesa tjetër e popullsisë në vilajetin e Manastirit, përjashto rastet e raportuara, “sillej e qetë dhe ishte në pritje”. Si duket shqiptarët, si p.sh. ata në Dibër, nuk e shikonin me simpati bashkëpunimin e kryengritjes me ushtarakët e rebeluar e të arratisur, nga se frikësoheshin se kjo mund të bëhej e rrezikshme për aspiratat kombëtare shqiptare.⁵⁹

Ndonëse, Tajar Beu në një letër të tij, datë 27 qershor 1912, fajëson për tradhti ndaj vendit të gjithë ata të cilët aspironin pavarësinë e Shqipërisë,⁶⁰ dezertimi dhe arratisja e ushtarakëve nga garnizonet e vilajetit të Manastirit, ishte me domethënie dhe jo e parëndësishme për kryengritjen shqiptare. E rëndësishme ishte se tani oficerë e nënoficerë të rebeluar së bashku me ushtarë iu bashkoheshin kryengritësve shqiptarë,⁶¹ por dhe disa kërkesa të tyre u referoheshin edhe interesave të shqiptarëve. Sipas gazetës “Politika” të Beogradit, ndër 10 kërkesat e krerëve të lëvizjes ushtarake të Manastirit të cilat i janë parashtruar qeverisë osmane, ishin edhe këto: ruajtja e sovranitetit të sulltanit mbi Shqipërinë dhe vendosja e vetëqeverimit në Shqipëri, do të thotë e një autonomie për Shqipërinë.⁶²

Ndërkaq, në gjysmën e parë të korrikut, kryengritja shqiptare po merrte gjithnjë e më shumë hov si në veri ashtu dhe në jug.⁶³ Në korrik të vitit 1912 përsëri u riaktivizua kryengritja e armatosur në Dibër. Në fillim të korrikut ishin të shpeshta përpjekjet luftarake ndërmjet ushtrisë dhe kryengritësve shqiptarë në Dibër të Vogël (Poshtme), në Rekë të Dibrës, në Mat, por pa ndonjë rëndësi të madhe.⁶⁴ Në Dibër vazhdonte të

⁵⁸ *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj-22-17-1763, Halla - Markgrafit, Manastir, më 25.06.1912; *po aty*, Halla - Markgrafit, Manastir, më 4.07.1912; *po aty*, Shtojcë e informacionit nga Manastiri, 4.07.1912, Lista e krerëve shqiptarë... .

⁵⁹ *Po aty*, Vj-22-17-1763, Halla - Markgrafit, Manastir, më 25.06.1912.

⁶⁰ *Po aty*, Vj-22-17-1763, Halla - Markgrafit, Manastir, më 4.07.1912; *po aty*, Shtojcë e raportit nga Manastiri, 4.07.1912.

⁶¹ “Стање у Турској”, *Политика*, бр. 3025, Београд, 21.06./6.07.1912.

⁶² “Буна у Турској”, *Политика*, бр. 3025, Београд, 21.06./6.07.1912.

⁶³ *ДАРМ*, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград., М. 904, ПП Бр. 715, Битољ, 11/24.07.1912, L. Mihajloviq, konsulli i Serbisë në Manastir, Ministrisë së PJ në Beograd; *Historia e popullit shqiptar ...*, II, f. 479-482.

⁶⁴ *Документи о спољној политици...*, Књига V, Свеска 1, dok. nr. 571, f. 892,

mbisundonte anarkia edhe nga mesi i korrikut. Kryengritësit i prenë linjat telegrafike dhe ndërprejnë çdo komunikim të Dibrës me Strugën, me Dibrën e Poshtme dhe me Zhernanicën. Njoftojnë se edhe rreth gjysma e ushtrisë nga postëkomandat ndihmëse iu bashkua kryengritësve.⁶⁵ Ndërkaq, në gjysmën e dytë të korrikut, kryengritja po merrte përpjesëtime më të mëdha në vilajetin e Manastirit. U shtua ndjeshëm numri i kryengritësve në Malësinë e Dibrës, në Mat, në Elbasan, në Korçë, në Kolonjë. Për shtypjen e kryengritjes në këto treva pushteti dërgoi trupa shtesë.⁶⁶

Por, kur nga mezi i korrikut të vitit 1912, thuhet në të gjitha “Trevat e Sipërme” të Shqipërisë, pra dhe në Tetovë e Gostivar, pushteti “legal” osman, po zëvendësohej me atë shqiptar, nga fundi i korrikut pushuan për një kohë veprimet luftarake ndërmjet fuqive kryengritëse shqiptare dhe forcave osmane.⁶⁷ Qeveria e re osmane, më 23 korrik, kishte lëshuar një urdhër telegrafik mbi tërheqjen e ushtrisë nga Shqipëria, një telegram me përmbajtje të tillë kishte arritur edhe në Manastir. Pas urdhrit për tërheqjen e ushtrisë, qeveria osmane priste që kryengritësit shqiptarë të kthehen nëpër shtëpitë e tyre, dhe kështu të përfundonte kryengritja.⁶⁸ Kurse, më 12-25 korrik 1912 qeveria osmane urdhëroi ndërprerjen e të gjitha operacioneve ushtarake kundër shqiptarëve.⁶⁹

Rezultatet e kësaj kryengritjeje më gjerësisht janë trajtuar në historiografinë shqiptare, ndaj dhe këtë punim do ta përfundoj me një vlerësim të ambasadorit britanik në Vjenë, më 28 gusht 1912, lidhur me këtë. Ai thotë: “Shqiptarët këtë vit kanë fituar gjithçka që kanë dashur por ende vetëm në letër, por nëse qeveria turke nuk i plotëson premtimet e

⁶⁵ “Дебар у пламену”, *Политика*, бр. 3028, Београд, 24.06./7.07.1912.

⁶⁶ *Документи о спољној ...*, Књг. 5, св. 1, док. нр. 684, ф. 1026.

⁶⁷ *ДАРМ*, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 1292, Битољ, 11/24.07.1912, Л. Милајловиќ, консули i Serbisë në Manastir, Ministrisë së РЈ në Beograd; *Документи о спољној политици...*, Књига V, Свеска 1, док. нр. 659, ф. 997, док. нр. 680, ф. 1021, док. нр. 682, ф. 1024; *Historia e Popullit Shqiptar ...*, II, ф. 484; Б. Храбак, “Арбанашки уста ...”, ф. 308, shih dhe referencën nr. 222.

⁶⁸ *ДАРМ*, Скопје, ф. Дипломатски архив-Белград, М. 904, ПП Бр. 715, Битољ, 11/24.07.1912, Л. Милајловиќ, консули i Serbisë në Manastir, Ministrisë së РЈ në Beograd.

⁶⁹ “Преговори са Арнаутима”, *Политика*, бр. 3046, Београд, 12/25.07.1912.

veta atëherë ndodhet përpara një lëvizje shqiptare edhe më të rrezikshme”.⁷⁰

Si përfundim, Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare e vitit 1912, kontribuoi drejt evoluimit të çështjes shqiptare, si në planin e brendshëm politik e kombëtar, ashtu edhe në planin diplomatik ndërkombëtar, që rezultoi me hapjen e shtegut drejt autonomisë politike të Shqipërisë.

⁷⁰ ДАРМ, Скопје, 18.4.207/460, Строго пов, Н. 1355, Ministria e Punëve të Jashtme, Legatës mbretërore në Londër.